Përqindja më e lartë të përgjigjeve positive të ankentuarve prej Gjilanit (në krahasim të qyteteve tjera) mund të shpjegohet me faktin në periudhën e kaluar, në këtë qytet, por edhe në Kosovë në përgjithësi, edhe në koncentrim më të lartë nga organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë me njerëz të rinj, duke implementuar projekte (në mes tjerash) në lëmin e pjesëmarrjes aktive të të rinjëve në shoqëri. Kjo pjesëmarrje është përkrahur nga administrata e UMNKUT. Në qytetet tjera prej GPKT regionit, përqindja e përgjigjeve positive është jashtëzakonisht e vogël, që prap na dërgon në një përfundim se organizatat më të mëdha kryesisht janë të koncentruara në qytetet kryesore. Ndarja e madhe e Trgovishtes (me 18,4%) me të vërtetë bazohet në faktin se punohet qytetin më të vogël të këtij regionit.

Sipas shkollave, përfaqësuesit e regjioneve, organizatat nacionale për të rinj janë më së shumti prezent në gjimnazet (42,7%), për dalim prej shkollave teknike (35,5%). Mirpo edhe përkrahë këtij raporti, nxënësit e shkollave teknike kanë perceptim më pozitiv për vlerësimin e iniciativave, në përgjithësi bashkëpunimi që realizohet me administratën. Sipas të dhënave të lart përmendura, ato mund të na udhëzojnë në dy përfundime se tek gjimnazet nuk janë realizuar projekte të cilat do të sjellin efikasitet, apo iniciativat nga organizatat rinore (sektori i OJQs në përgjithësi) nuk kanë hasur në përkrahje tek administrata e shkollës.

17.




Njëri nga supozimet për pjesmarje aktive të nxënësve nëpër organizatat regjionale dhe nacionale është niveli i informimit se si funksionojn këto organizata. Në këtë kontekst, për të anketuarit të cilët janë deklaruar se kanë përfaqësues të këtyre organizatave nëpër shkollë, kanë vijuar edhe disa pyetje, me të cilat dëshironim të fitojm një fotografi për pozitën dhe rolin e këtyre organizatave në përfaqësimin e interesave dhe mënyrën e funksionimit.

Në pyetje e parashtruar „ **A i përfaqësojnë interesat tuaja organizatat nacionale siç është Zyra e Unionit të nxënësve të shkollave të mesme?**”

47.9% janë përgjigjur me „Nuk e di”, 35.9% janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 16.1% negativisht. Nga të dhënat e fituara, mund të përfundojm se gati se gjysma e të anketuarve nuk kanë qenë të informuar për punën e këtyre organizatave. Për ata të anketuarit nuk kanë formuar qëndrim për efikasitetin e veprimit, nuk janë në gjendje që të vlerësojnë aktivitetin e tyre dhe ndikimin e tyre në realizimin e interesave të nxënësve. Nga ana tjetër, mund të supozojm se organizatat nacionale të shkollave nuk kanë qenë të hapura dhe të lidhura me nxënësit, pastaj pikërisht këto organizata nuk janë vlerëtuara në praktik si një formë e vlefshme më të cilat mund të shprehin dhe të zgjidhen interesat dhe nevojat e nxënësve. Sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, përgjigjet e shqiptarëve nuk kanë përjashtime nga distribucioni normal. Te serbët më së shumti ka përgjigje pozitive me (43.6%) në aspekt të përfaqësimit të interesave të nxënësve nga ana e organizatave, ndërsa tek maqedonasit sundon një qëndrim indiferent që është shprehur më modalitetin „Nuk e di” (73.9%). Sipas pjesëmarrjes së qyteteve, përgjigjet e të anketuarve nga Gjilani dhe Tërgovishtja kanë përjashtime nga distribucioni normal i të dhënave. Ato kryesisht kanë deklaruar se organizatat nacionale në shkollë i përfaqësojnë interesat e tyre, ndërsa në qytete tjera (Kumanovë dhe Preshevë) janë fituar të dhëna të ngjajshme më distribucionin normal.

18.




Pyetja në vijim është e lidhur me organizatat nacionale në shkollë me këtë vijim ” **A janë të zgjedhur këta përfaqësues në mënyr demokratike?**”

Edhe në këtë pyetje paraqiten të dhëna të ngjajshme si në pyetjen e mëpar, përkatësisht numri më i madh i të anketuarve janë deklaruar „Nuk din” (67.7%), në cilën mënyrë janë të zgjedhur antarët e atyre organizatave, pastaj 20.8% janë deklaruar se antarët janë të zgjedhur në mënyrë demokratike, të tjerët 11.5% mendojnë se përfaqësuesit e tyre nuk janë të zgjedhur në mënyrë demokratike. Duke marrë parasysh gjininë e të anketuarve, numrë më i madh i

meshkujve janë deklaruar se zgjedhjet e përfaqësve të tyre është në mënyr demokratike (30.5%), për dallim nga femrat (16.5%), të cilat kanë treguar një skeptizim rreth mënyrës së zgjedhjeve demokratike. Më rëndësi është të përmendët edhe fakti se të anketuarit prindërit e të cilëve kanë nivel më të ulët të arsimit e deklarohen se përfaqësuesit e tyre janë të zgjedhur në mënyr demokratike.


19.



Pastaj të anketuarve i u është parashtruar pyetja me qëllim të marrim të dhëna për mundësitë e tyre që të marrin rol aktiv në këto organizata. Pyetja është parashtruar në këtë mënyrë „ **A keni mundësi të mirrni pjesë në aktivitete të ndonjë organizate nëse keni interesim?**” Numri më i madh i të anketuarve kanë dhënë qendrime pozitive në lidhje me këtë pyetje (45.8%) dhe se organizata janë të hapura për antarsim të ri dhe se kanë mundësi të kuçen, nëse dojnë. Përqindja e atyre që mendojnë se mund të kuçen, vetëm nëse organizatat i ftojnë është (42.7%), dhe në fund nuk mund të lajm anash është numri i atyre të cilët kanë deklaruar se organizatat janë të mbyllura për antarsim të ri (11.5%). Rezultatet nga të dhënat e lartpërkruara na tregojnë një pretendim pozitiv se organizata janë të hapura për antarsim të ri. Nga analiza e përgjigjeve, veçanërisht është me rëndësi të shqyrtohet struktura e të anketuarve në bazë të të dhënave socio-demografike. Sipas gjinis, vitit të shkollimit dhe përkatësisë nacionale kemi disa përjashtime hasen tek meshkujt (54.2%), tek nxënësit të vitit të I (50.5%) dhe Tërgovishtë (100.0%), ku numër më i madh i të anketuarve janë deklaruar se do të kuçen në ndonjë organizatë nëse i ftojnë.

E. Influenca Juaj

20.



Pyetja e parë që ishte parashtuar për ndikimin e nxënësve që e kanë mbi procesin e sjelljes së vendimeve nga ana e administratës së shkollës, ka dhënë rezultate bregosëse. Në pyetjen e parashtuar **”Mendoj se qëndrimet e mija kanë rëndësi gjatë sjelljes së vendimeve relevante që më preokupojnë”** 12.2% prej të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht; 23.7% janë përgjigjur me ”Ndonjëher”; 29.2% janë përgjigjur me “Ndonjëher, por vetem për vendime që kanë rëndësi të vogël”, ndërsa 27.8% janë përgjigjur negativisht. Rraporti i krahasimit sipas qyteteve ka dhënë këto të dhëna:

Tabela 5: *Mendoj se mendimi im ka rëndësi për shkollën kur administrata sjell vendime relevante që mua më preokupojnë*



Qyteti	“gjithmon”	“ndonjëher”	„ ...vetem për vendime të rëndësishme”	“asnjëherë”
Kumanovë	11,9%	29,7%	30,3%	28,1%
Gjlan	15,6%	39,6%	21,9%	22,9%
Preshvë	12,2%	28,7%	25,4%	33,7%
Tërgovisht	5,3%	23,7%	60,5%	10,5%

Dallimi në përgjigjeve mvaret nga gjinia e të të anketuarit. Ashtu që, shumica e përgjigjeve negative vërrehën tek femrat (29.1%), për dallim nga meshkujt (26.1%).

Përgjigje me struktur të ndryshme hasëm tek nxënësit të vitit të III negativisht janë përgjigjur 35.5%, për dallim nga ata të vitit të I me 20.5% kanë dhënë përgjigje me “Asnjëher”. Analiza sipas shkollave pjesmarse në anketim tregon se ka përjashtime të mëdha nga distribucioni normal, por prap shkollat teknike kanë disa përqindje më shumë përgjigje pozitive.

Edhe tek kjo pyetje mund të vertetohet ligjshmëria sipas të së cilës nxënësit prindërit e të cilëve janë me kualifikime më të larta (sin ë arsim, ashtu edhe në profesion) kanë numër të madh të përgjigjeve negative. Kjo na dërgon në një përfundim për rëndësin e rrethit social ku jetojm, si dhe botkuptimet tona si dhe te drejtat e shprehjes së mendimeve dhe si ndikojn në sjellen e mendimeve.

21.



Më tutje, që të fitojm të dhëna për qëndrimet e nxënësve, ide dhe probemet ndaj ndonji subjekti në rrethin e shkollës, të ankëtuarit i pyetëm që të deklarohen për qëndrimin që vijon **"Kam mundësi lirishtë të flas për idet, problemet e mia etj, me personat në vijim"**, në tabelen në vijim mund të shifen rezultate e fituara:

Tabela 6: Mund lirishte te flas per idet, problemet me personat ne vijim

Subjekta në shkoll	Po	Jo	Gjithsej
Drejtori	24,8	75,2	100,0
Pedagogu/psikologu	35,0	65,0	100,0
Mësimdhënës	73,6	26,4	100,0

Besim më i madh nxënësit kanë treguar ndaj mësimdhënësve (73.6%). Subjekti i ardhshëm me të cilin nxënësit mund hapurazi të bisedojnë është pedagogu, përkatësisht psikologu i shkollës (35.0%). Shpërndarja e kësaj e notave për besim, përkatësisht për afërsi me subjektet e shkollës është pritur, dhe paraqet një shpërndarje të logjikshme të kohës së kaluar të atyre subjektve me nxënësit dhe niveli i komunikimit mes tyre. Nga kjo del se nxënësit kohën më të madhe e kalojnë me mësimdhënësit, çka edhe formon një afërsi më të madhe, dhe ata janë të njoftuar me të gjitha problemet, idet dhe qëndrimet e nxënësve. Pastaj vjen pedagogu dhe psikologu, të cilët duhet të kujdesen për komunikimin e nxënësve dhe më mirë të shqyrtohen nevojat e tyre. Në fund vjen drejtori (24.8%), i cili gjendet në krye të kësaj hierarchie dhe që njohësisht ai është në distancë më të largët për komunikim me nxënësit. Sipas të dhënave të fituara për qytetet e përfshira, vërehet një përjashtim në lidhje me afërsin e psikologut/pedagogut nga shkolla e tyre.


Tabela 7: Mund lirishte te flas për idet, problemet me personat në vijim (për qytet)

Qyteti	në %		
	Po	Jo	Gjithsej
Kumanovë	41,1	58,9	100,0
Gjilan	39,6	60,4	100,0
Preshevë	17,7	82,3	100,0
Tërgovishtë	76,3	23,7	100,0

Nga kjo tabel mund të konstatojmë se të anketuarit nga Tërgovishta (76,3%) kanë perceptim pozitiv për bashkëpunimin dhe komunikimin me pedagogun/psikologun e shkollës së tyre. Gati se gjysma nga të anketuarit nga Kumanova (41.1%) janë deklaruar se kanë bashpunim me pedagogun dhe psikologun, të dhëna të ngjajshme kemi edhe për Gjilanin (39.6%). Në Preshevë paraqitet perceptim i kundërt për marrëdhëniet me pedagogun dhe psikologun, vetëm 17.7% nga të anketuarit nga ky ëjtët mund lirishtë të bisedojnë me pedagogun e shkollës së tyre.


F. Vendimarrja

22.



Pjesa e gjashtë e këtij pyetësi i u është dedikuar mardhënieve mes nxënësve dhe procesit të sjellejs së vendimeve, me qëllim që të vërtetohet se a egziston diskriminim mes nxënësve. Ashtu, në pyetjen e parë në këtë pjesë (pyetja me numër 22): "Nxënës të klasës e respektojnë gjithmonë mendimin tim për çështje të lidhura me shkollën?". Janë fituar këto të dhëna: "Gjithmonë"- 39.6%; "Ndonjëherë" 55.0% dhe "Asnjëherë" 5.2%. Nëpër qytete, ka përjashtime në përgjigjet në Kumanovë (me 33.0% përgjigje pozitive), për dallim nga tre qytetet tjera të cilët kanë përgjigje përafërsisht të ngjajshme (43% kanë dhënë përgjigje "Gjithmonë"). Në këtë pyetje nuk janë hasur përjashtime tek të anketuarit në baz të gjinis, vendbanimi (qytet apo fshat). Numër më i madh i përgjigjeve pozitive hasen tek nxënësit të vitit të I (44.2%) në krahasim me nxënësit e vitit të III (34.7%), tek nxënësit e gjimnazit janë fituar 44.2% përgjigje pozitive ndërsa tek shkollkat teknike me 36.5% të përgjigjeve pozitive. Ligjshmëria që ishte gjetur tek grupet tjera në baz të profesionit të prindërve dhe nivelit të arsimit, tek kjo pjesë e pyetësit nuk është vërtetuar. Përgjigje pozitive për disa nijansa më shumë të pranishme tek prindërit të cilët kanë nivel më të lartë të arsimit, çka na sjell në një përfundim se egziston diskriminim mes nxënësve sipas rrethit social prej ku kanë preardhje.


23.



Edhe një dimension kërkimit për vendimarrje në shkollë paraqet edhe shqyrtimi i madhënieve mes nxënësve dhe bashkëpunimi mes tyre. Në pyetjen e parashtruar: ” **Pse mendoni se nxënësit e klasës se nuk e respektojnë mendimin tuaj?** ” të dhënat e fituara janë dhënë në tabelën në vijim:

Nga rezultatet e fituara mund të konkludohet se numër më i madh i nxënësve (33.8) besojn se në shkollë vlersohen mendimet e nxënësve të cilët janë të famshëm mes mësimdhënësve. Mbas tyre janë ata të cilët mendojnë se çmohen vetëm mendimet se të ”mençurve” (25.8%) dhe të nxënësve të ”famshëm” (25.5). Eshtë interesant fakti se 8.9% nga nxënësit janë deklaruar se çmohen mendimet e nxënësve të ”mençur”. Përgjigjet e të anketuarve meshkuj dallohen nga distribucioni normal, ashtu që tek grupi referent përgjigje me frekuente është se mendimet më shumë çmohen nga nxënësit e mençur (33.6%). Janë paraqitur përjashtime sispas shkollës se ku mësojnë nxënësit. Tek të anketuarit nga gjimnazi më shumë dominon qëndrimi se çmohen mendimet vetëm të nxënësve të shkëlqyeshëm (16.2%), në krahasim me nxënësit e shkollave teknike (4.7%). Duke i analizuar përgjigjet e dhëna sipas qyteteve mund të hasen përjashtime në përgjigje të të anketuarve nga Gjilani dhe Tërgovishtën. Ashtu që 45.5% nga të anketuarve nga Gjilani janë përcaktuar për modalitetin e dytë (”Çmohen vetëm mendimet e nxënësve të ”mençur”), ndërsa 52.4% nga Tërgovishta mendojnë se vetëm çmohen mendimet e nxënësve të ”famshëm”.

24.




Në qëndrimin e dhën ”**Cdo vendim i rëndësishëm që ka të bëjë me shkollën, sillen nga ana e vetëm disa nxënës të klasës ?**”, 40.8% janë përgjigjur me ”po”, përkundër 59.2% nga ata që janë përgjigjur me ”jo”. Përgjigje pozitive në këtë pyetje janë deklaruar edhe numër i madh i nxënësve në shkollat teknike (43.2%), përdundër të anketuarve nga gjimnazi (37.2%). Numër më i madh i nxënësve të vitit të parë e ndajn qëndrimin për pabarazin mes tyre kur është në pyetje sjellja e vendimeve për punë të cilët kanë ata i brengosin (44.2%), ndërsa tek nxënësit të vitit të III është 37.2%. Sipas qyteteve, numër më të vogël të përgjigjeve pozitive ka në Preshevë me 28.7%, në Tërgovishta me 42.1%; në Kumanovë 44.3%, ndërsa në Gjilanë me 56.3%, fakt çka befason, duke marr parasysh të anketuarit nga ky qytet kanë më së shumti përgjigje pozitive në pyetjet që ishin të lidhura me prezencën e përfaqësuesve të ndryshëm të organizatave të ndryshme nëpër shkollat të cilët i përfaqësojnë interesat e tyre. **Ky fakt duhet të alarmoj se**

pikërishtë organizata e tilla nuk janë mjaft inkluzive dhe transparente në punën e tyre.

Janë hasur edhe dallime të vogla në këtë pyetje mes nxënësve nga vendbanime rurale (me 43.2% përgjigje pozitive), përkundrazi ata të cilët jetojnë në qytete(38.8%), ndërsa sipas gjinis, dallime të tilla nuk janë gjetur. Përfundim të ngjajshëm mund të hasim si në pyetjen e me numër 22 edhe për këtë pyetje, përveç asaj se te kjo pyetje disproporcioni është edhe më i madh. Sa më i ulët që është statusi i prindërve të të anketuarve (niveli i arsimit, përkatësisht lloji i profesionit), aq më e shprehur është qëndrimi se vendimet me rëndësi i sjell numër i vogël i nxënësve. Për shembull, pozitivisht në këtë pyetje janë përgjigjur 76.9% nga të anketuarit prindërit e të cilëve nuk kanë të kryer shkolën fillore, ndërsa përqindja e të anketuarve prindërit të të cilëve janë më nivel të arsimit univerzitar paraqet 33.3%. Dallimi në këtë rast vërehet shumë shpjet dhe e njëjta mund të vërehet duke analizuar përgjigjet sipas nivelit të arsimit të nëns, si dhe profesionit të të dy prindërve. **Rezultatet e kësaj dhe në përgjithsi të të gjitha pyetjeve në këtë pjesë (nga pyetja me numër 22 deri 25), tregojnë diskriminimi në baz të statusit social është i pranishëm tek nxënësit dhe ndikon në mënyrën se si ata organizaohen mes veti.**

25.



Mund të thuhet se mardhëniët mes nxënësve paraqet një indikator për klimën çka mbizotron në shkollë dhe udhheqjen demokratike të shkollës. Që të fitojm një fotografi më të qart për këtë problem, ajo grup e nxënësve të cilët mendojnë se vetëm disa nxënës sjellim vendime relevante kërkuja që ti paraqesin dhe të deklarohen për shkaqet të cilat sjellin deri tek kjo gjendje. Në pyetjen „**Përse mendoni se pakica sjell vendime të rëndësishme të lidhura me punët e shkollës?**”, kan dominuar përgjigjet e atyre nxënësve të cilët janë të përkrahur nga ana e profesorëve me (46.6%), vetëm 25.5% mendojnë se pakica vendos përshkak se japin zgjidhje më të mira për problemet e tyre. Vazhdojnë ata të cilët mendojnë se nuk i jipet shanse nxënësve të tjerë të shprehin qëndrimet dhe mendimet e tyre (17.1%) dhe 10.8% mendojnë se ata

nxënës sjellin vendime përshkak se janë të famshëm në mesin e nxënësve. Në baz të përpunimit të dhënave mund të përfundojm se përgjigjet janë të determinuara nga disa karakteristika socio-demografike të të anketuarve. Nga variablat të cilat ishin të kyçura në këtë kërkim, më më rëndësi ishin dallimet tek nacionaliteti, niveli i arsimit dhe profesioni i prindërve si dhe nga lloji i shkollës se ku mësojnë.

Tabela 8: Përse mendoni se pakica e nxënësve sjell vendime të rëndësishme të lidhura me punët e shkollës?(sipas nacionalitetit)

Nacionaliteti	në %				
	Janë të përkrahur nga ana e mësimdhënsve	Nuk i jipet mundësi nxënësve të tjer të shprehin qëndrimin e tyre	Janë të famshëm në mes nxënësve	Gjithmon japin zgjidhje më të mira për problemet	Gjithsej
Maqedon	55,6%	29,6%	14,8%	/	100,0%
Shqiptarë	50,4%	14,1%	10,7%	24,8%	100,0%
Sërb	30,8%%	19,2%	7,7%	42,3%	100,0%
Romë	100,0%	/	/	/	100,0%
Turqë	50,0%	/	50,0%	/	100,0%

Edhe në këtë rast përkatësia nacionale ka ndikuar në preferencën e modaliteteve. Nga tabela mund të shifet se egzistojn disa përjashtime tek të anketuarit maqedonas dhe serb, përkatësisht maqedonasit mendojnë se ajo grup e vogël nuk jep zgjidhje më të mir për problemet, por përkundrazi, më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se ata sjellin vendime përshkak se janë të përkrahura nga ana e mësimdhënsve (55.6%). Tek serb kemi një shikim tjetër, se nxënësit e zgjedhur japin zgjedhje më të mira për të gjitha problemet (42.3%). duke marr parasysh nivelin e arsimit të prindërve të të anketuarve, mund të shifet se tek ata nxënës prindërit e të së cilëve kanë nivel të lart të arsimit mendojnë se nxënësit sjellin vendime përshkak se janë të përkrahur nga ana e mësimdhënsve. Rezultatet e kryqzuara nga kjo pyetje me profesionin e prindërve, në një mënyrë të vërtetë edhe rezultatet e kryqzuara në pyetjen e mëpar. Nëse e shikojn modalitetin e parë („janë të përkrahur nga ana e mësimdhënsve”), që dominon në distribucionin normal, shifet se kjo përgjigje haset tek të anketuarit prindërit e të cilëve janë më profesion bujq, puntor në fabrik apo të papunësuar. Sipas llojit të shkollës ku mësojnë nxënësit, nxënësit e gjimnazit më së shumë janë deklaruar se pakica e nxënësve të cilët sjellin vendime, më të vërtetë sjellin vendimet më të mira për zgjidhjen e problemeve (33.8%). Në vazhdim janë të paraqitura përgjigjet e të anketuarve sipas përkatësisë nacionale dhe sipas qyteteve ku është realizuar kërkimi.

Tabela 9: Përse mendon se pakica e nxënësve nga klasa e jote sjellin vendime për problemet në shkollë?(sipas qyteteve)

Qyteti	Janë të përkrahur nga ana e mësimitdhënsve	Nuk i jipet mundësi nxënsve të tjer të shprehin qëndrimin e tyre	Janë të famshëm në mes nxënsve	Gjithmon japin zgjidhje më të mira për problemet	Gjithsej
Kumanovë	57,5	7,5	12,5	22,5	100,0
Gjilan	39,4	16,9	9,9	33,8	100,0
Preshevë	46,9	30,6	8,2	14,3	100,0
Tërgovishtë	47,7	11,4	13,6	27,3	100,0

G. Lobimi në shkollë


26.



Në pjesën e fundit të këtij pyetesori shtë përpiluar që të shifet se a egzistojn lobime në vetë shkollën, si nga ana e mësimitdhënsve është dhe nga ndonje palë e tretë. Në pyetjen se „ **A ka bërë ndonjëri nga mësimitdhënsit ndonjë komentare/qëndrim politikë gjate kohës së mësimit?**” me përgjigje „po” janë deklaruar 38.6% nga të anketuarit. me 33.3% nga viti i I, ndërsa 44.2% të anketuar nga viti i III, kanë dhënë përgjigje pozitive. Ky fakt nuk duhet të na befaso, përshkak se nxënësit nga viti i III dhe IV, shumica e tyre e fitojnë të drejtën e votimin ashtu që mund të jën nën ndikim të „lobimit të partive politike” në shkollën e tyre. Krahasuar me shkollat, numër shumë më i madh dhe më i vlershëm, të lobimeve është hasur në gjinazet (47.7%), për dallim nga shkollat teknike në këtë pyetje me „po” janë përgjigjur 32.6% nga të anketuarit. Duke analizuar sipas qyteteve, shkall më të lart të ndikimit politik në procesin mësimit është vërejtur tek të anketuarit nga Gjilani me 53.1%; të Preshevës më 42.5%, që është fakt se e ilustron tensionin politik ne këto dy


qytete. Pastaj vijojn Kumanova (me 32.4% përgjigje pozitive), Tërgovishta me 13.2% përgjigje pozitive.

27.



Përveç konstatimit se mësimdhënësit a deklarojn qëndrime politike gjat procesit mësimor, deshëm të informohemi për frkuencën e paraqitjes dhe çfar lloji te komentve më së shpeshti përdoren. Dominon numri i të anketuarve të cilët deklarojn se njëher apo dyher ka ndodhur (60.1%), pastaj vijojn ata të cilët deklarojn se ka ndodhur pesë apo më teperher që mësimdhënësit të deklarojn qëndrime apo komente politike gjatë procesit mësimor (20.2%), dhe në fund në mes jana ata të cilët janë deklaruar ka ndodhur tri deri ne katër her (19.7%). Është interesnt të vërehet fakti për nxënsit nga gjumnazi më përkatësi maqedonë dhe shqiptarë tek të cilët dominon modaliteti se ka ndodhur njëher deri në dy, por më së pakti pës hër apo më shumë, çka na tregon se niveli I ndikimt te lobimit politik në shkoll është në zvoglim.


28.



Dimenzion tjetër në përpunimin e këtij problemi ka qenë ***lloji të komenteve politike që mësimdhënsit i kanë deklaruar gjatë procesit mësimor.*** Përgjigjet këtu kanë qenë gati se të ngjajshme, përkatësihtë 54.4% janë deklaruar se më së shpshti jipen komente pozitive për partint e tyre politike, kundër 42.5% të cilët janë përgjigjur se më së shumti jipën komente negative për partin që nuk e përkrahin. 3.1% nga të anketuarve deklarohen se

komentët e mësimdhënsve më së shpësi janë qëndrime positive apo negative për Unionin Europjan. Sipas përkatesis gjinore, tek të anketuarit meshkuj përgjigja më dominante janë komentet negative të mësimdhënsve (55.7%), për dallim nga femrat të anketuara tek të cilat hasen përgjigje në form të distribucionit normal. Përjashtime janë hasur, tek shkolla se ku mësojnë, ku përgjigjet e nxënësve të gjymnazit janë të ndara sipas llojit të komenteve të mësimdhënsve, komentë negativë (49.5%), pozitive me (48.4%), ndersa tek të anketuarit nga shkollat e teknike dominojnë komentë pozitive (60.2%), përdallim nga komentet negative (35.7%). Gjendja sipas qyteteve në përgjithsi, përgjigjet janë të shpërndara si distribucioni normal, në Kumanovë ka një përqindje të madhe të komenteve për Unionin Europjan, për dallim nga qytete tjera, lloji i komenteve mungon vetëm në Tërgovishtë (0.0%).

29.



Pyetja e fundit në pyetësor ishte pyetja në vijim: **“A është bërë ndonjë lobim për ndonjë nga partit politike ndokushë që nuk është nga shkolla juaj (afër shkollës apo në oborin e shkollës)?”**. Pozitivisht janë deklaruar 15.2% nga nxënësit. Lobimi politik nga ana e palës së tret për një nian më shumë është paraqitur tek nxënësit të vitit të III (16.5%), kundër atyre të vitit të I (14% më përgjigje positive). Dallim i madh egziston sipas shkollave. Ashtu që 11.6% nga të anketuarit nga shkollat teknike janë përgjigjur se egziston lobim politik në shkollë nga ndonjë person i tret, ndërsa kjo përqindje tek nxënësit të gjimnazit është shumë më e madhe me 20.6%. Të dhënat sipas qyteteve janë dhënë në tabelën e mëposhtme. Si edhe ke pyetja me numër 25, edhe këtu numër më i madhë të përgjigjeve positive kemi në Gjilan, ku secili katri nxënës ka vërejtur aktivitete politike në kuadër të shkollës se ku mëson.

Tabela 10: *“A ka bërë ndonjë lobim për ndonjë nga partit politike ndokushë që nuk është nga shkolla juaj (afër shkollës apo në oborin e shkollës)?”*

Qyteti	Po	Jo
Kumanovë	12,4%	87,6%
Gjilan	25,0%	75,0%
Preshëvë	14,4%	85,6%
Tërgovishtë	7,9%	92,1%

IV. Konkluzione për rezultatet e paraqitura

Nga kërkimi i bërë dhe rezultatet e fituara mund të konstatohet se perceptini i nxënësve mvaret nga karakteristikata socio-demografike. Rezultatet nga analiza e të dhënave mund ti rezimojm kështu si më vijim:

- ***Mos egzistimi i një modeli të definuar që i përfaqsim të interesave të nxënësve.*** Besimi shumë i vogël në Unionet e shkollave të mesme me vetëm 4.2%, ndërsa besim me të madh në trupat unitar të shkollës. Në Tërgovishtë as që figuron Qyra lokale e Unionit të nxënësve të shkollave të mesme, si trup i shkollës i cili sjell vendime relevante për problemet e nxënësve;
- ***Organizata rinore jotransparente.*** Organizatat rinore kryesisht janë të koncentruara nëpër kryeqytet, dhe nuk kanë rrejt mjaft të zhvilluar nëpër shkolla, nuk janë mjaft inkluzive me aktivitete të tyre dhe në pranimine e anëtarëve të rritur (numër i madh i të antekuarvë as atë që din se këto organizata i përfaqsojnë interesat e tyre dhe se anëtarët e të njëjtave janë të zgjedhur në mënyrë demokratike;
- ***Mos egzistimi i një menyre konkrete të bashkëpunimit të mësimit dhe administratës së shkollës me nxënësit dhe njëkohësisht egzistimi i një tretman i pabarabart me iniciativat e nxënësve***
- ***Evalimi i punës së mësimit është incidentete*** (49.0% nga të anketuarit janë përgjigjur se nuk kanë mundësi të bëjnë vlerësim), ndërsa aty ku ka, nuk forohet vetëdijë për rëndësinë e vlerësimit;
- ***Diskriminim valid dhe brengosës mes nxënësve*** ku çmohet dhe vlerohet vetëm mendimi i disa nxënësve (më së shpeshi të atyre nxënësve të cilët janë më të "famshëm" mes mësimit), sjellja e vendimeve në klasë bëhet me anë të pak nxënës edhe atë prap më përkrahjen e mësimit, e jo ata të cilët sjellin vendime më të mira;
- ***Nxënësit janë të shfaqur nën ndikime politike gjate dhe jashta procesit mësues***, si nga ana e mësimit edhe ashtu edhe nga njerz të tjer.

Rekomandime për mënyra dhe drejtime për veprim:

- ✓ Definimi i modeleve për organizata shkollore, mënyren e bashkëpunimit me administratën, me obligime nga përpara të definuara dhe ingjencia në procesin e sjelljes së vendimeve;
- ✓ Përgjegjesi më të madhe dhe shqyrtim me fleksibil nga ana e administratës dhe mësimdhënësve i inicijativave të nxënësve, me qëllim për pjesmarje të nxënësve në sjelljen e vendimeve të reja si dhe ndryshimin e rregullave të vjtra në rrethin e shkollës si dhe rrespektimi i së drejtës për zgjedhje;
- ✓ Te formohet klimë transparente, e hapur dhe përkrahje të përbashkët dhe ku nxënësit do të jëtë të kyçur në misionin e shkollës, si dhe të behen pjesë e zinxhirit të vendimarrjes.
- ✓ Të nxitohet në përmisimin e bashkëpunimit të shkollave me sektorin e OJQve;
- ✓ Organizimin e takimeve formale dhe joformale mes drejtorëve dhe nxënësve si modele të bashkëpunimit të administratës së shkollës dhe nxënësve;
- ✓ Vlersim i rregullt për situatën në shkollë, formimin e politikës së vlërsimit dhe evaluimit si dhe sistem të evaluimit;
- ✓ Tejkalmi i jobarazis/diskriminimit mes nxënësve përmes tranimeve për stereotipe dhe paragjykime si dhe tejkalmimin e tyre
- ✓ Formimi i një atmosfere me energji pozitive për përkrahje të përbashkët dhe ndihmë, përmes komunikimit të pa dhunshëm si dhe punës në grupe;
- ✓ Ngritja e nivelit të kontrollës të institucioneve përkatëse për eliminim e ndikimeve politike mbi nxënësit.